



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 6063 / 2 Prot.

Tiranë, më 16 . 12 .2024

U R D H Ë R

Nr. 624 , datë 16 . 12 .2024

**“PËR KLASIFIKIMIN E INSTITUCIONEVE TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMEVE PENALE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 7, të Ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të pikës 5, të nenit 15, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, përcjellë më shkresën nr. 18228, datë 19.11.2024,

**URDHËROJ:**

1. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Ali Demi” klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion institucion i hapur.
2. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion për të dënuar të sigurisë së lartë dhe/ose zakonshme dhe të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor, si dhe një seksion paraburgimi.
3. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë klasifikohet institucion për gratë dhe të dënuarat e mitura, si dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e lartë, me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion siguri e ulët, me një seksion institucion i hapur dhe një seksion paraburgimi.
4. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Malësi e Madhe (Reç) klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e lartë, me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion paraburgimi.
5. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë - Krujë klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e lartë, me një

seksion siguri e zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

6. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Jordan Misja” klasifikohet institucion paraburgimi, me një seksion paraburgimi dhe një seksion për personat që konsiderohen “bashkëpunëtorë të drejtësisë”, sipas kritereve të ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 *“Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”*, i ndryshuar.
7. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë klasifikohet institucion për të dënuarit e mitur dhe institucion paraburgimi, me një seksion burgimi, me një seksion paraburgimi, me një seksion për personat që konsiderohen bashkëpunëtorë të drejtësisë, sipas kritereve të ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 *“Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”*, i ndryshuar, me një seksion siguri e ulët për të rinjtë e moshës 18 deri në 21 vjeç dhe një seksion të sigurisë së zakonshme për të rinjtë e moshës 18 deri në 21 vjeç.
8. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e lartë, me një seksion për zbatimin e regjimit të posaçëm dhe një seksion paraburgimi.
9. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e lartë, me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion për personat që konsiderohen bashkëpunëtorë të drejtësisë, sipas kritereve të ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 *“Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”*, i ndryshuar, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion paraburgimi.
10. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e lartë, me një seksion siguri e zakonshme dhe një seksion paraburgimi.
11. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tepelenë klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e zakonshme dhe një seksion paraburgimi.
12. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lushnjë klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur, me një seksion siguri e zakonshme dhe një seksion siguri e ulët.
13. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur, me një seksion siguri e zakonshme dhe një seksion siguri e ulët.
14. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penal Lezhë klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur, institucion paraburgimi dhe institucion i kujdesit shëndetësor për personat për të cilët gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme,



me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion paraburgimi dhe me një seksion për personat për të cilët gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme.

15. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale "Mine Peza" klasifikohet institucion paraburgimi, me një seksion paraburgimi.
16. Qendra Spitalore e Burgjeve klasifikohet institucion i kujdesit shëndetësor për të burgosurit.
17. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë klasifikohet institucion paraburgimi, me një seksion paraburgimi.
18. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier klasifikohet institucion për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e lartë, me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion për personat që konsiderohen bashkëpunëtorë të drejtësisë, sipas kriterëve të ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 "*Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë*", i ndryshuar, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion paraburgimi.
19. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat klasifikohet institucion paraburgimi, me një seksion paraburgimi.
20. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës klasifikohet institucion paraburgimi, me një seksion paraburgimi.
21. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan klasifikohet institucion paraburgimi, me një seksion paraburgimi.
22. Urdhri nr. 8927/1, datë 27.09.2018 "*Për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale*" i Ministrit të Drejtësisë dhe të gjithë urdhrat e tjerë të bazuar në këtë urdhër, shfuqizohen.

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
Ulsi Manja

